



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.973/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija – Ymeri dhe Ramush Bardiqi anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore – administrative te paditësit – propozuesit te shtyrjes se ekzekutimit te vendimit "A..." B.I B.F., me seli ne fshatin Pasjan, Komuna Partesh, kundër te paditurit - kundërshtarit te shtyrjes se ekzekutimit te vendimit Administrata Tatimore e Kosoves, me seli ne Prishtine, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Departamenti Fiskal, KF.nr.348/2023, i datës 11.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. **15/05/2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa paditësit – propozuesit "A..." B.I B.F., me seli ne fshatin Pasjan, Komuna Partesh dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Departamenti Fiskal, KF.nr.348/2023, i datës 11.04.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar e ka hedhe poshtë si te palejuar revizionin e parashtruar nga paditësi - propozuesi, "A..." B.I B.F., me seli ne fshatin Pasjan, Komuna Partesh, kundër aktvendimit te Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkalles se Pare KF.nr. 348/23 te datës 10.01.2024.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë nga paditësi - propozuesi, "A..." B.I B.F., me seli ne fshatin Pasjan, Komuna Partesh, për shkak të shkeljeve esencialë të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktik dhe aplikimit të gabuar të ligjit materiale, me propozimin që shfuqizohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Departamenti Fiskal, KF.nr.348/2023, i datës 11.04.2024 dhe çështja te kthehet ne rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala e paditur..

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i shtyrjes se ekzekutimit te vendimit, ka paraqitur propozim per shtyerjen e ekzekutimit te vendimit i cili i është refuzuar, e ndaj te cilit propozuesi ka paraqitur ankese, kurse me aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës se Dyte, K.DH.SH.II.nr.1517/23 te datës 17.11.2023, i është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës se Pare - Departamenti Fiskal, KF.nr.348/2023 te datës 26.09.2023, me te cilin është refuzuar propozimi-kërkesa e paditësit për shtyerjen e ekzekutimit t aktit administrativ përfundimtar-vendimit me nr.prot.67/2023 te datës 17.03.2023, te te paditurit Administratës Tatimore e Kosovës me seli ne Prishtine, kurse kundër aktvendimit te lartcekur te Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkalles se Dyte, paditesi ka parashtruar revizion. Gjykata Komerciale Dhomat e Shkalles se Pare, e cila me aktvendimin KF.nr.348/23 me date 10.01.2024, parashtresën e paditësit te datës 03.01.2024 e ka kthyer ne plotësim me qellim te precizimit te sakte se cilin mjet juridik e ka parashtruar, e ku pala paditëse serish ka njoftuar se ka parashtruar mjetin e jashtëzakonshëm, te quajtur revizion.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit te propozuesit, përkritazi me revizionin, me aktvendimin e atakuar e ka hedhe poshtë si te palejuar revizionin e parashtruar nga paditësi - propozuesi, "A..." B.I B.F., me seli ne fshatin Pasjan, Komuna Partesh, kundër aktvendimit te Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkalles se Pare KF.nr. 348/23 te datës 10.01.2024, ne kuptim te nenit 24, te Ligjit për Konfliktet Administrative, (LKA), ku parashihet se "kundër vendimit te formës se prere te gjykatës kompetente për çështje administrative të shkalles së dyte, pala mund te parashtroje ne Gjykatës Supreme, kërkesë per rishqyrtim të jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor dhe se kërkesa mund te parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes te drejtës materiale, ose te shkeljeve te dispozitave të procedurës, qe do te mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes. "

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdhe në përfundim se ankesa është e pabazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është kontradiktor me vetvete si dhe nuk ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetim të aktvendimit janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare.

Po ashtu gjykata e shkalles se dyte, ka vlerësuar se drejte ka vendosur gjykata e shkalles se parë, duke u nisur nga gjendja e tille e çështjes dhe dispozitave te cekura te Ligjit për Konflikte Administrative kjo gjykatë gjen se, kundër vendimeve te formës se prere për çështje administrative te shkalles se dyte, pala mund te parashtroje ne Gjykatës Supreme kërkesë për rishqyrtim te jashtëzakonshëm te vendimit gjyqësor, ndërsa prokurori publik kërkesë për mbrojtje te ligjshmërisë. Rrjedhimisht, rezulton se me

revizion nuk mund te kontestohen as vendimet e formës se prere te Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkalles se dyte lidhur me aktgjykimet dhe aktvendimet e nxjerra sipas ankesës se ushtruar ndaj aktvendimeve dhe aktgjykimeve te Divizionit Fiskal te Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkalles së pare, por as ndaj aktvendimeve procedurale te Gjykatës Komerciale -Dhomat e Shkalles se pare lidhur me aktvendimet e nxjerra ne procedure te shqyrtimit paraprak te parashtrave te palëve, ne kuptim te nenit 218 te LPK-se lidhur me nenin 63 te LKA-se

Gjykata Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe si i tillë mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, e që eventualisht do te mund te përbejë arsye për anulimin e këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles së Dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr.973/2024, dt.15.05.2024

KRYETARI I KOLEGJIT,
Faton Bajrami, d.v